



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo -Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Kryesia e Kuvendit  
P-67  
Prishtinë, më 2 qershor 2009, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 2 QERSHOR 2009**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Mufëra Shinik dhe Sllobodan Petroviq.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ibrahim Makolli, Ardian Gjini, Lulzim Zeneli dhe Xhezair Murati.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skender Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Selman Ymeri dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja, Petrit Hysaj,  
Nga NDI-ja, Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe tri pika shtesë.

Kryesia, me propozim të Kryetarit, miratoi këtë.

### **R e n d d i t e:**

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 26 maj 2009,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave,
4. Te ndryshme.

#### **1. Miratimi Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 26 maj 2009**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 26 maj 2009, u miratua pa vërejtje.

#### **2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme të Kuvendit**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi, në pjesën e parë të muajit qershor, t'i mbajë tri seanca plenare.

##### **2.1 Seanca plenare më 4 qershor 2009, me këtë rend dite:**

1. Zgjedhja e Avokatit të Popullit.

##### **2.2 Seanca plenare më 11 qershor 2009 me këtë rend dite:**

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën sociale në Kosovë,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural,
7. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores së Kuvendit,
8. Shqyrtimi i Raportit të Radio-Televizionit të Kosovës, për vitin 2008,
9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës,
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2010-2012,

11. Shqyrtimi i Raportit vjetor për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Kosovë, për vitin 2008 (shpërndarë: më 15 maj 2009),
12. Shqyrtimi i Raportit të Autoritetit Rregullator për Telekomunikacion, për vitin 2008,
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për përkrahjen e Projektit multietnik për komunën e Novobërdës,
14. Njoftimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionin parlamentar,
15. Njoftimi me shpërbërjen e Grupit Parlamentar “Zajedno”.

### **2.3 Seancë plenare më 12 qershor 2009, me këtë rend dite:**

1. Shqyrtimi i Raportit financiar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2008.

### **3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave**

#### **3.1 Shqyrtimi i kërkesës së deputetëve për procedimin dhe miratimin e Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

Kërkohej nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave që ta përshpejtojë procedimin e Deklaratës financiare për implikimet buxhetore për zbatimin e Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë të deputetit.

#### **3.2 Shqyrtimi i vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për emërimin e zëvendës drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës, si dhe emërimin e dy anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi vendimin e cekur më lart, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

Kërkohej nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi që ta shqyrtojë Vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e zëvendës drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë së Pronës dhe emërimin e dy anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Pronës dhe Kuvendit t’ia paraqesë Raportin me rekomandime.

#### **3.3 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Këshillit për Trashëgimi Kulturorë, për sigurimin e kushteve të punës**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lart, nxori këtë

## **P Ë R F U N D I M**

Të njoftohet Këshilli për Trashëgimi Kulturore se kërkesën për sigurimin e kushteve të punës duhet ta procedojë gjatë fazës së rishikimit të buxhetit të vitit 2009.

### **3.4 Shqyrtimi i kërkesës së sekretarit të Kuvendit të Kosovës për mbyllje të avansit**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Kërkohej informacion shtesë lidhur me mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit në Bullgari nga ana e organizatorit.
2. Miratohet kërkesa për mbylljen e avansit të udhëtimit në Bullgari, prej 1 deri më 2.10.2008, sipas vendimit nr. 03-V79, në shumën prej 180.02 euro.

### **3.5 Shqyrtimi i kërkesave të Grupit Parlamentar të AAK-së**

Grupit Parlamentar të AAK-së kishte parashtruar dy kërkesa: a) për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të pagjetur dhe Peticione, e cila është radhitur në rend dite për seancën plenare më 11 qershor 2009, dhe b) rivendosjen e radhës për diskutim në seancë plenare, radhën e ulëseve në mbledhjet e Kryesisë dhe të ulëseve në sallën e seancave plenare të Kuvendit.

**Kryesia**, pasi diskutoi për kërkesën nën b), konstatoi se kjo çështje duhet të analizohet në përputhje me procedurat e Kuvendit, si dhe për këtë të vendoset pas pushimit vjetor, përkatësisht në fillim të sesionit vjeshtor.

### **3.6 Shqyrtimi i Raportit për shpenzimet të Kuvendit për tremujorin e parë të vitit 2009**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi Raportin e shpenzimeve, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Miratohet Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2009.
2. Buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2009 të zbatohet sipas Ligjit nr. 03/1-105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009, sidomos në kategorinë ekonomike për paga dhe mëditje.
3. Nevojat eventuale të Kuvendit për vitin 2009 të paraqiten për shqyrtim në kërkesën buxhetore me rastin e rishikimit të buxhetit për vitin 2009.

### **3.7 Shqyrtimi i kërkesës së deputetëve për lejimin e udhëtimit zyrtar në Maqedoni**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

## V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve Naim Maloku dhe Berat Luxha, në Strugë, Maqedoni, prej 4 deri më 7 qershor 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i mbulon organizatori, ndërsa mëditjet shtesë (30%) përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

### **3.8 Njoftimi me vendimin e deputetit Dragisha Miriq**

Kryesia u njoftua me vendimin e deputetit Dragisha Miriq, i cili ishte tërhequr nga Grupi Parlamentar “Zajedno” dhe në të ardhmen do të veprojë si deputet i pavarur.

Kryesia vendosi që ta njoftojë seancën plenare me vendimin e deputetit Dragisha Miriq, përkatësisht për shpërbërjen e Grupi Parlamentar “Zajedno”, ngase nuk e ka numrin e mjaftueshëm të deputetëve për të funksionuar si grup parlamentar.

### **3.9 Shqyrtimi i vazhdimit të kontratës së sekretarit të Kuvendit**

Kryetari njoftoi Kryesinë se sekretarit të Kuvendit edhe një muaj i skadon afati i kontratës së punës, andaj Kryesia e Kuvendit duhet të vendos lidhur me këtë.

Ai tha se, përkundër vështirësive që e kanë përcjellë administratën e Kuvendit, është i mendimit që sekretarit të Kuvendit t’i vazhdohet kontrata e punës edhe për një mandat.

Anëtarët e Kryesisë mbështetën propozimin e Kryetarit.

Në fund, Kryesia me propozim të Kryetarit, mori këtë

## V E N D I M

1. Sekretarit të Kuvendit të Kosovës, Ismet Krasniqi, i vazhdohet kontrata e punës edhe për tre (3) vjet, duke filluar nga data 01.08.2009.
2. Ngarkohet Seksioni i Personelit që t’i ndërmarrë veprimet juridike në përputhje me këtë vendim.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit,  
**Jakup KRASNIQI**

---

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**